



Sindikata Kombëtare e Operatorëve Telefonikë, SKOT

Email: sindikatacallcenter@gmail.com

Cel: +355 69 63 43 532

RAPORT

6 MUJORI I PARE I 2022

Objektivat që kemi arritur në 6 mujorin e parë të vitit 2022.

1. Përfaqësimi me sukses i punonjësve të kompanisë Bconnect sh.p.k, Durrës në ruajtjen e vendeve të tyre të punës, nëpërmjet protestave të vazhdueshme derisa ata arritën të ruanin vendet e punës. Vazhdimi i përfaqësimit në gjykatë të punonjësve të Bconnect sh.p.k Tiranë deri në fitimin e të drejtës së tyre.
Përballja me diskriminimin e kryetares së Skot pranë kësaj kompanie dhe negocimi që Skot i bëri kësaj çështje, nëpërmjet partnerëve ndërkombëtar derisa kompania pranoi diskriminimin, dhe dëmshpërbleu kryetaren e Skot.
2. Duke parë mungesën e informimit të të rinjve dhe të rejave anëtarë të Skot dhe punonjës të sektorit Call Center, Skot ka ndërmarrë një fushatë këshillimi ligjor falas. Pranë zyrave tona u paraqiten me dhjetëra punonjës në jave, të cilët u informuan me këshilla ligjore falas në bazë të problematikës së tyre.
3. Një nga objektivat kryesorë që Skot arriti për 6-mujorin e parë të 2022 ishte edhe mbështetja sindikale dhe ligjore e punonjësve të kompanisë Albacall sha, në procesin e pushimit kolektiv nga puna. Proces i cili kulmoi me fitimin e të gjitha të drejtave që u takonin me ligj të 528 të rinjve dhe të rejave punonjës të Albacallit.
4. Një nga objektivat e sindikatës Skot ishte edhe ndjekja e zbatueshmërisë së marrveshjes së lidhur me kompaninë Transcom Durrës, lidhur me zbatimin e Kodit të Punës, përsa i përket ditëve të festave zyrtare dhe rritjes së pagës për punonjësit.
5. Një tjetër objektivi i Skot ishte zbutja e pasojave të punës nga shtëpia, për rreth 20.000 të rinj dhe të reja punonjës të sektorit Call Center, duke ndërmjetësuar me kompanitë për rimbursimin e pagesës së internetit, energjisë elektrike etj. Gjithashtu Skot në frymën e bashkëpunimit trepalësh dhe dialogut social, negocioi dhe vazhdon të negociojë me Qeverinë Shqiptare për dypunësimin dhe heqjen e pagesës së DIVA (taskë mbi dypunësimin).
6. Fushata mbi shtimin e numrit të anëtarëve, ishte gjithashtu një nga objektivat primar të Skot. Fushatë e cila u zhvillua në cdo kompani Call Center, në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër etj, duke arritur të merrnim kontakt me gati 90% të punonjësve të sektorit.

Edhe përgjatë 6 mujorit të parë të 2022 Skot ka vazhduar të jetë pikë epiqendra për zgjidhjen e problematikave të punonjësve të sektorit Call Center.

Vazhdojmë të jemi prezent në të gjitha kompanitë e sektorit Call Center në Republikën e Shqipërisë duke përfaqësuar denjësisht 25.000 të rinj e të reja punonjës të sektorit.

Mediat sociale kanë qënë një nga asetet dhe prioritetet më të rëndësishme të Skot. Nëpërmjet tyre arrijmë të përcojmë zërin e Skot në cdo cep të Shqipërisë, duke arritur të mbajmë të informuar cdo anëtar të sindikatës dhe jo vetëm, për të gjitha problematikat dhe të rejat e sektorit. Për më tepër informacion referojuni linqeve të mëposhtëm:

<https://www.facebook.com/SKOT.SINDIKATA>

<https://www.instagram.com/skot.sindikata/>

Aktivite dhe takime

Aktivitetet dhe takimet kanë qënë të shumta në 6-mujorin e parë të 2022. Viti nisi me takimin në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë, ku kryetari i Skot foli përpara të rinjve dhe të rejave studentë në këtë fakultet, lidhur me sindikatën dhe organizimin sindikal.

Gjithashtu Skot ka marrë pjesë në takimet periodike të Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian, si anëtar i saj dhe përfaqësues i sektorit.

Skot në kuadër të bashkëpunimit me partnerët e tij si: OLOF Palme Center , CLR, Friedrich-Ebert-Stiftung, Inspektoriati Qëndror i Punës, ILO etj, ka marrë pjesë në konferencat e shumta të organizuara prej tyre.

Skot ka mbajtur takime dhe aktivitete periodike të strukturave të saj, lidhur me vendimarrje të rëndësishme për sa i përket sindikatës.

Kapaciteti institucional

Kapaciteti institucional i Skot është forcuar në mënyrë të dukshme dhe cdo strukturë ka marrë formën e saj, si në nivel kombëtar, rajonal dhe në nivel kompanie.

Media

Mediat janë një nga partnerët kryesorë të Skot në denoncimin e problematikave të sektorit, duke qënë prezent në cdo protestë të Skot dhe duke i dhënë hapësira problematikave të ndryshme që sindikata ngritur me punonjësit e sektorit.

<https://fb.watch/gHebYmEpgz/>

<https://fb.watch/gHee2CMK2x/>

<https://fb.watch/gHefILFOhK/>